

“Ta bëjmë të padukshmen, të dukshme” Histori të dhunës ndaj grave dhe fëmijëve

Ka kaluar një vit tashmë, por zëri i saj ende dridhet kur ajo kujton natën kur e gjeti mbyllur derën e shtëpisë së saj nga bashkëshorti. “Sapo isha kthyer nga puna atë pasdite pasi kisha marrë vajzën nga çerdhja. I rashë derës pa pushim dhe prita për dy orë, por dera nuk u hap.”

Luljeta, 23 vjeç, ka lindur në një fshat të Lezhës në Shqipëri. Pas mbarimit të shkollës së mesme, u fejuua dhe më pas u martua me djalin që donte. Erdhi në Tiranë, ku jetonte bashkëshorti i saj. Çdo gjë dukej në rregull për çiftin e ri deri në shtatzani. “Ishim bashkë në maternitet kur morëm vesh se prisja një vajzë. Ai më la atje vetëm; iku pa thënë asgjë.” E turbullt, ajo u kthye në shtëpi, po papritur diçka ishte thyer. “Ai nuk e donte fëmijën, sepse ishte vajzë. Donte që unë ta abortoja.”

Pas lindjes së vajzës, ish bashkëshorti shfaqti hapur shenja dhune. Një ditë, Luljeta e gjeti vajzën duke qarë, me shenjë të kuqe në faqe. “E pyeta vajzën dhe më tha: babi më

rrafi. Ishte vetëm dy vjeç në atë kohë.” Ky ishte vetëm fillimi i një përvoje të tmerrshme që Luljeta uron ta harrojë. Për të shpëtuar nga jeta e dhunshme në familje, ajo kërkoi ndihmë. Shkoi tek komisarati më i afërt i policisë së bashku me vajzën natën që i shoqi e la jashtë shtëpisë. Komisarati e vuri në kontakt me “Shtëpinë e Ngjyrave”, një qendër ditore dhe

Falë ndihmës financiare nga Bashkimi Evropian, UNICEF në partneritet me ARSIS siguron strehë emergjence, këshillim psikologjik, mbështetje ligjore dhe shërbime të kohës së lirë për fëmijët dhe gratë, mbijetues të abuzimit dhe dhunës. Të gjitha shërbimet ofrohen pa pagesë dhe konfidencialiteti i përfituesve respektohet rreptësisht.

ofruese e shërbimit të emergjencës për fëmijët, menaxhuar nga organizata lokale ARSIS. Qendra është hapur në vitin 2011 si rezultat i bashkëpunimit midis UNICEF-it Shqipëri, bashkisë së Tiranës dhe ARSIS-it për të trajtuar nevojat emergjente të fëmijëve dhe grave të prekura nga dhuna dhe që prej asaj kohe ky bashkëpunim vazhdon.

Luljeta emocionohet gjatë intervistës dhe ne ndalojmë, pasi vajza e saj është afër nesh. Ajo është vetëm 3 vjeç dhe mbase nuk i kupton plotësisht ato për të cilat po bisedojmë, por ajo i ndjen të gjitha, mbase më mirë se të rriturit. Ndaj ne ndërrojmë temë, duke e pyetur për kopshtin, lodrat dhe menjëherë fytyra i ndriçohet. Përgjigjet me “po”, “jo” ose me fjalën e fundit të pyetjes, dhe me një buzëqeshje të madhe.

Ka qenë një vit i vështirë për Luljetën, por ajo pranon se është “më mirë sesa të jetosh në mëshirën e një personi të dhunshëm. Nuk e di ku do të isha sot

pa ndihmën e policisë, organizatës ARSIS dhe Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve. Shqetësimi im kryesor është mirëqenia e vajzës,” thotë ajo. Luljeta qëndroi dy net në Shtëpinë e Ngjyrave dhe më pas u zhvendos tek Qendra Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje. “U ndjeva e mbrojtur dhe mora mbështetjen emocionale që më nevojitej aq shumë.”

Luljeta po kërkonte një vend tjetër për të jetuar vetëm me vajzën. Në fshat nuk mund të kthehej, pasi familja e saj ishte e varfër dhe perspektiva për të dhe vajzën nuk ishte aq e mirë. Kështu, pas një muaji, ajo e la qendrën dhe u lidh me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve, referuar nga ARSIS.

Elisabeta është punonjësja e NJMF-së që ka ndjekur rastin e Luljetës. “Së bashku me menaxherin e rastit të ARSIS-it vizituam familjen dhe vlerësuam situatën e saj,” tregon ajo. “E ndihmuam Luljetën të gjente punë në një fabrikë, ndërsa qeranë e apartamentit ia pagoi një OJF për një vit. Vajza u regjistrua në kopësht. Në varësi të emergjencës, ne sugjerojmë paketa ushqimore falas dhe Luljeta po i merr ato. Gjithashtu e futëm Luljetën në skemën e ndihmës ekonomike dhe kemi filluar procedurat për marrjen e një banese sociale, pasi ajo nuk mund ta përballojë qeranë vetëm me rrogën e saj.”

Luljeta sheh nga vajza. “Ajo është shumë më e qetë dhe e lumtur tani, por sërish ka makthe natën lidhur me periudhën kur jetonte me të atin,” thotë Luljeta. “Unë do të bëhem e fortë për të dhe për veten time.”

Luljeta dhe vajza e saj mund të jetojnë tani të lira nga dhuna. Megjithatë, të dyja janë ende të brishta.

Dhuna në familje në Shqipëri është një problem serioz dhe i përhapur,



me një studim të fundit nga Instituti Kombëtar i Statistikave INSTAT, tregon se rreth 53 përqind e grave kishin përjetuar dhunë në familje brenda 12 muajve të fundit.

Pasi viktimi / mbijetuesi i dhunës të kontaktojë një nga anëtarët e Mekanizmit të Referimit – nuk ka rëndësi se cili anëtar është kontaktuar i pari - ai anëtar duhet menjëherë të fillojë vënien në lëvizje të sistemit të mbështetjes, duke informuar së paku një përfaqësues nga Bashkia, Policinë dhe Strukturat Shëndetësore. Shërbimet që i ofrohen viktimës / të mbijetuarit mund të jenë shërbime afatshkurtra dhe afatgjata. Në afat-shkurtër, këto shërbime përfshijnë: mbrojtje dhe siguri të menjëhershme, mbrojtje shëndetësore dhe akomodim (duke përfshirë transportin në një vend të sigurt), si dhe informacione dhe asistencë për të filluar procedurat për marrjen e një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje ose për ndjekjen

penale të rastit. Ndërkohë, në varësi të rastit, mund t'i referohet edhe institucioneve të tjera. Mbështetja afatgjatë, përfshin referimin në zyrat e punësimit për mbështetje për punësim, marrjen e disa rekomandimeve profesionale, referimin në departamentin e shërbimeve sociale për ndihmë ekonomike, strehim afatgjatë, këshillim ligjor dhe asistencë në rast se i mbijetuari dëshiron të fillojë procedurat e divorcit ose të strehojë një ankesë kundër dhunuesit, këshillave dhe psikoterapisë për t'u shëruar nga trauma, por edhe për riintegrim dhe asistencë për fëmijët (domethënë transferimi në një kopsht tjetër ose shkollë, këshillim / terapi, nëse është e nevojshme, etj.). – (“Raport i paraqitur nga Shqipëria sipas nenit 68, paragrafi 1 i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”).



unicef 
for every child

Për më tepër informacion, kontaktoni
David Gvineria
Specialist në sektorin
e Mbrojtjes së Fëmijëve
Rr. Skenderbej, Ndërtesa e UN, Kati 3
Shqipëri
Tel. +355 (4) 2273335
Email: dgvineria@unicef.org

alo  116
A phonenumber protecting
children across Albania